



**VENDIM**

*Nr. 93, Datë 09.06.2016*

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
MBI NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 88 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të ERE, në lidhje me miratimin e “Rregullores mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”

**Konstatoi:**

- ERE është organi kompetent për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje.
- Rregullorja e ndryshimit të furnizuesit përcakton kushtet, të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve dhe klientëve të energjisë elektrike

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “Rregullores mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE  
Petrit AHMETI**